

## Sbulesa e Joan Theollogut.

---

### Krye 1.

- 1 Sbulesa e Jisu Krishtit, të-cilënë j'a dha ati Perëndia, që t'u dëftenjë shërbëtorëvet të ti sa duhetë të bënenë për-së-çpejti; edhe i dërgoj e i çfaq i me anë të ëngjëllit të ti
- 2 mbë shërbëtorin' e ti Joan; l-cili dëshmoj për fjalën' e Perëndisë, edhe për dëshmimn'
- 3 e Jisu Krishtit, edhe për sa pa. Lum ay që këndon, edhe ata që dëgjonjënë fjalët' e *kësaj* profitie, edhe ruanjënë sa janë shkruarë

- nd' atë; sepse koha është afërë.
- 4 Joani mbë të shtatë kishët që janë nd' Asi; hir edhe paqtim *qoftë* mbë ju nga ay që është edhe që ishte edhe që vjen; edhe nga të shtatë frymatë që janë përpara fronit
- 5 P' ati; Edhe nga Jisu Krishti, që është dëshimimtari besëtar, i-parë linduri prej së-vdekurish, edhe zotënia i mbretërvet të dheut; mb' atë që na deshi, edhe që na lau nga
- 6 fajetë t' anë me gjakun' e ti, Edhe që na bëri mbretër edhe priftër të Perëndia edhe Ati i ti, mb' atë *qoftë* lavdia edhe pushteti ndë jetët të jetëvet. Amin.
- 7 Ja te vjën bashkë me retë, edhe dot' a shohë atë çdo sy, edhe ata që e çpuan' atë; edhe dotë ulërinjën mb' atë gjithë kombet'
- 8 e dheut; po, amin. Unë jam Allfa e Omega, (të-nisurit' edhe të-mbaruarëtë,) thotë Zoti, Ay që është edhe që ishte edhe që vjen, Gjithëpushtetësi.
- 9 Unë Joani, që jam edhe vëllaj juaj, edhe pjesëtar bashkë me ju ndë shtrëngimt edhe ndë mbretërit edhe ndë durimt të Jisu Krishtit, qeshë ndë ujdhesët që quhetë Patmë, për fjalën' e Perëndisë, edhe për dëshmimn' e Jisu Krishtit.
- 10 Arçë ndë frymë ditën' e-djelë; edhe dëgjova prapa meje *një* zë të-math posi zë trumbete,
- 11 I-cili thoshte, (Unë jam Allfa edhe Omega, i-pari edhe i-pastajmi; edhe,) Ç' sheh, i shkujaj ndë vivli, edhe u'a dërgo kishëvet (që

- janë ndë Asi,) nde Efesë, e ndë Smyrnë, e ndë Përgamë, e ndë Thyatirë, e ndë Sardhë, e ndë Filladhelfi, e ndë Llaodhiqi.
- 12 Edhe ukthyeshtë të shoh zënë që foli me mua; edhe kur ukthyeshtë, pashë shtatë kandilevet t' arta, Edhe ndë mest të shtatë kandilevet *një* që gjante me bir njeriu, veshurë me një rrobë të-gjatë gjer ndër këmbë, edhe
- 14 ngjeshurë për anë sisëvet *një* bres t' artë. Edhe kryet' e ati edhe flokët' e ati ishinë të-bardhë posi lesh i-bardhë, si dëborë; edhe
- 15 syt' e ati posi flakë zjarri; Edhe këmbët' e ati gjaninë me hallkolivan, si të-ndezurë ndë furrë; edhe zër' i ati posi zë shumë ujërash.
- 16 Edhe kishte ndë dorët të ti të-djathhtë shtatë yj; edhe nga goja e ati dilte një shpatë e-prehëtë me dypresje; edhe faqeja e ati *ndritte* posi djelli që ndrit ndë tuqit të ti. Edhe kur pashë atë, rashë ndë këmbët t' ati posi i-vdekurë; edhe ay vuri dorën' e ti të-djathhtë mbi mua, e më tha, Mos ufrikëso, unë jam
- 18 i-pari edhe i-pastajmi, Edhe ay që rron; edhe qesh' i-vdekurë, edhe ja tek jam i-gjallë ndë jetët të jetëvet; (amin;) edhe kam
- 19 kyçet' e hadhit, edhe të vdekjesë. Shkruaj ato që pe, edhe ato që janë, edhe ato që janë për të bërë paskëtaj; Fshehësirën' e të shtatë yjvet që pe mbë të-djathhtë t' ime, edhe të shtatë kandilet' e-artat. Të shtatë yjtë janë ëngjëjt' e të shtatë kishëvet; edhe të

shtatë kandiletë (që pe) janë të shtatë kishëtë.

Krye 2.

- 1 Shkruaj ëngjëllit të kishës' s' Efesësë,  
 Këto thotë ay që mban të shtatë yjtë ndë  
 të-djathtët të ti, ay që ecën ndë mest të  
 2 shtatë kandilevet të-arta; I di punërat' e tua,  
 edhe mundimnë t' ënt, edhe durimnë t' ënt,  
 edhe se s' munt të duronjç të-liqtë, edhe se  
 provove ata që thonë se janë aposto, edhe  
 3 nukë janë; edhe i gjete gënjeshtarë. Edhe  
 vove, edhe ke durim, edhe për emërinë t'im  
 4 umundove, edhe nuk' ulodhe. Po *diç* kam  
 kundrë teje, sepse e le dashurinë t' ënde të-  
 5 parënë. Kujtohu pra nga re poshtë, edhe pen-  
 dohu, edhe bëj punërat' e-para; ndë mos,  
*dotë* vinj çpejt te ti, edhe dotë luanj kandi-  
 lenë t' ënde nga vëndi i asaj, ndë mos upen-  
 6 dofsh: Po ke këtë *të-mirë*, se u ke mëri pu-  
 nëravet të Nikollaitëvet, të-cilavet u kam  
 mëri edhe unë.  
 7 Ay që ka vesh, letë dëgjonjë ç' u thotë  
 Fryma kishëvet; Atij që munt dot' i ap të  
 hajë nga druri i jetësë, që është ndë mest  
 të paradhisit të Perëndisë.  
 8 Edhe ëngjëllit të kishës' së Smyrnasvet  
 shkruaj,  
 Këto thot' i-pari edhe i-pastajmi, i-cili  
 9 që i-vdekur' edhe rroj; I di punërat' e tua  
 edhe shtrëngimin' edhe vobëzinë, (po je i-

- pasurë,) edhe vllasfimin' e atyreve që thonë  
 për vetëhen' e tyre se janë Judhenj, edhe  
 nukë janë, po janë mbledhje e Satanajt.  
 10 Mos ufrikëso fare nga sa ke për të pë-  
 suarë; ja djalli te ka për të vënë ca prej  
 jush ndë burk, që të provohi; edhe dotë kini  
 shtrëngim dhjetë dit. Bënu besëtar gjer mbë  
 vdekje, edhe dotë t' ap kurorën' e jetësë.  
 11 Ay që ka vesh, letë dëgjonjë ç' u thotë  
 Fryma kishëvet; Ati që munt nukë dot' i  
 bënëtet keq prej vdekjes' së-dytë.  
 12 Edhe ëngjëllit të kishësë ndë Pergamë  
 shkruaj,  
 Këto thot' ay që ka shpatën' e-pre-  
 13 hëtë me dy presje; I di punërat' e tua,  
 edhe ku e ke të-ndënjuritë, e ke atje ku  
*është* fron' i Satanajt; edhe mban emërinë  
 t'im, edhe nukë mohove besënë t' ime, edhe  
 nd' ato dit që *ishte* Antipa, dëshmimtari im  
 besëtar, i-cili uvra ndër ju, atje ku ka të-  
 14 ndënjuritë Satanaj. Po kam pak *gjë* kundrë  
 teje, sepse ke atje ca që mbanjënë mësimin'  
 e Ballaamit, i-cili mësonte Ballakunë të bë-  
 një skandhali përpara të bijvet të Israilit,  
 që të hanë kurbanë idhujsh edhe të kurvë-  
 15 ronjënë. Kështu ke edhe ti *ca veta* që mba-  
 njënë mësimin' e Nikollaitëvet që e kam  
 16 mëri. Pendohu; se ndë mos, vinj çpejt te ti,  
 edhe dotë luftonj kundrë atyreve me shpa-  
 tën' e gojësë s' ime.

- 17 Ay që ka vesh, letë dëgjonjë ç' u thotë Fryma kishëvet; Ati që munt dot' i ap të hajë nga manna që është fshehurë, edhe dot' i ap *një* haliq të-bardhë, edhe mbi haliq është shkruarë një emërë i-ri, të-cilin' asndonjë s' e njuh veç ay që e merr.
- 18 Edhe ëngjëllit të kishësë ndë Thyatirë shkruaj,  
Këto thot' i Bir' i Perëndisë, ay që ka syt' e ti posi flakë zjarri, edhe këmbët' e
- 19 ati gjanjënë me hallkolivan; I di punërat' e tua, edhe dashurinë, edhe shërbesënë, edhe besënë, edhe durimnë t' ënt, edhe punërat' e tua, edhe të pëstajmetë *se janë* më të-tepëra
- 20 se të-paratë. Po kam (pak *gjë*) kundër teje, se lë gruanë Jezabelë, që thotë për vetëhen' e saj se është profitëreshë, të mësonjë edhe të kobonjë shërbëtorët' e mi që të kurvëronjënë
- 21 edhe të hanë kurbanë idhujsh. Edhe i dhashë kohë asaj të pendonetë nga kurvëria e
- 22 saj, edhe nuk' upendua. Ja unë tek e vë atë ndë shtrat, edhe ata që kurvëronjënë me atë ndë shtrëngim të-math, ndë mos upëndof-
- 23 shinë nga punërat' e tyre. Edhe të bijt' e asaj dot' i vras me vdekje. Edhe gjithë kishëtë dotë njohënë, se unë jam ay që vëshgonj veshnjat' edhe zëmëratë; edhe dot' i ap gjithë-
- 24 sicilit prej jush pas punëravet' uaj. Edhe u them juve edhe të-tjerëvet *që janë* ndë Thyatirë, sa s' kanë këtë mësim, edhe të-cilëtë s'

- i njohnë thellësirat' e Satanajt, sikundër tho-
- 25 në, Nukë dotë vë tjetërë barrë mbë ju; Po atë që keni mba-e-ni, gjer sa të vinj.
- 26 Edhe ati që munt, edhe që ruan punërat' e mia gjer ndë funtt, dot' i ap ati pushtet mbi
- 27 kombet; Edhe „dotë kullosnjë ata me shkop të-hekurtë; dotë thyhenë posi enët' e shtëm-barit;“ sikundër edhe un' i mora prej t' im
- 28 Et; Edhe dot' i ap ati yllin' e mëngjesit.
- 29 Ay që ka vesh, letë dëgjonjë ç' u thotë Fryma kishëvet.

### Krye 3.

- 1 Edhe ëngjëllit të kishësë ndë Sardhë shkruaj,  
Këto thotë ay që ka të shtatë frymat' e Perëndisë, edhe të shtatë yjtë; I di punërat' e tua, se e ke emërinë se rron, edhe je i-vdekurë. Benu i-sgjuarë, edhe forco të-mbeturëtë sa janë gati për të vdekurë; sepse nuk' i gjeta punërat' e tua të-sosura
- 3 përpara Perëndisë. Kujtohu pra qysh morë edhe dëgjove, edhe ruaj-i, edhe pendohu. Ndë mos ndënjç pra sgjuarë, dotë vinj te ti posi vjedhës, edhe nukë dotë dish mbë ç' orë dotë
- 4 vinj te ti. Ke pak emëra edhe ndë Sardhë, qe nuk' i ndynë rrobat' e tyre; edhe dotë ecënjënë bashkë me mua me *rroba* të-bardha, sepse janë të-vëjyerë. Ay që munt, ky dotë vishtë me rroba të-bardha; edhe nukë dotë shu-

anj emërin' e ati nga vivlia e jetësë, edhe dotë rrëfenj emërin' e ati përpara t' im. Et, edhe përpara ëngjëjvet t' ati.

6 Ay që ka vesh, letë dëgjonjë ç' u thotë, Fryma kishëvet.

7 Edhe ëngjëllittë kishësë ndë Filladhelfi shkruaj,

Këto thotë shënjeti, i-vërteti, ay që ka kyçin' e Dhavidhit; ay që hap, edhe asndonjë s' mbyll; edhe mbyll, edhe asndonjë

8 s' hap; I di punërat' e tua; ja tek kam vënë përpara teje një derë të-hapurë, edhe asndonjë s' munt t' a mbyllnjë atë; sepse ke pak fuqi, edhe ruajte fjalënë t' ime, edhe nukë

9 mohove emërinë t' im. Ja tek dot' i bënj ata nga mbledhja e Satanajt që thonë për vetëhen' e tyre se janë Judhenj, edhe nukë janë, po gënjenjënë; ja tek dot' i bënj ata të vinjën' e të falenë përpara këmbëvet të tua,

10 edhe të njohënë se unë të desha ty. Sepse ruajte fjalën' e durimit t' im, edhe unë dotë të ruanj ty nga ora e ngasjesë që ka për të ardhurë mbë gjithë botënë, që të provonjë

11 ata që rrinë mbi dhet. Na tek vinj çpejt; mba atë që ke, që të mos marrë ndonjë kurorënë t' ende. Kush të muntnjë, atë dot' a

12 bënj shtyllë ndë tempullt të Perëndisë t' im, edhe nukë dotë dalë më jashtë; edhe dotë shkruanj mbi atë emërin' e Perëndisë t' im, edhe emërin' e qytetit të Perëndisë t' im, të

Jerusalimit të-ri, që sbret prej qiellit nga Perëndia im, edhe emërinë t' im të-rinë.

13 Ay që ka vesh, letë dëgjonjë ç' u thotë Fryma kishëvet.

14 Edhe ëngjëllittë kishës' së Llaodhiqeasvet shkruaj,

Këto thot' ay që është Amin, besëtari edhe i-vërteti dëshmimtar, të-nisurit' e kriesës' së

15 Perëndisë; I di punërat' e tua, se as i-ftohëtë je as i-ngrohëtë; makar të ishnje i-ftohëtë,

16 hët' a i-ngrohëtë; Po passi je kështu i-vakëtë, edhe as i-ftohët' as i-ngrohëtë, dotë të

17 vjell nga goja ime. Sepse thua, Se jam i-pasurë, edhe ubësh' i-pasurë, edhe s' kam

nevojë as prej ndonjëj, edhe nuk' e di se ti je i-ngratë, edhe i-mjerë, edhe i-vobek, edhe

18 i-verbërë, edhe i-sveshurë. Të këshillonj ty të blesh prej meje ar të-provuarë ndë zjarr,

që të bënesh i-pasurë; edhe rroba të-bardha, që t'i veshç, edhe të mos duketë turpëria e të-sveshurit t' ënt;

edhe lyej syt' e tu me kol-lurë që të shohç. Unë gjithë sa i dua, i qër-tonj edhe i mundonj; ki zili pra edhe pen-

20 dohu. Ja tek rri ndë derët edhe trokëllinj; ndë dëgjoftë ndonjë zënë t' im, edhe hap de-

rënë, dotë hynj tek ay, edhe dotë darkonem bashkë me atë, edhe ay bashkë me mua.

21 Ati që munt dot' i ap të rrijë bashkë me mua ndë front t' im, sikundrë edhe unë munda,

edhe ndënja bashkë me t' im. Atë ndë

front t' ati.

- 22 Ay që ka vesh, letë dëgjonjë ç' u thotë Fryma kishëvet.

**Krye 4.**

- 1 Pas këtyre pashë, e ja një der' e-hapurë ndë qiellt; edhe zër' i-parë, që dëgjova posi zë trumbete që fliste bashkë me mua, thoshte; Hipë këtu, edhe dotë të dëftenj sa duhetë të bënenë paskëtaj.
- 2 Edhe përnjëhere arçë ndë frymë, edhe ja tek ishtë një fron ndë qiellt, edhe mbi front
- 3 ishtë ndënjurë një; Edhe ay që rrinte gjantë mbë të-parët me gur jaspidhe edhe sardhine; edhe *ishte* një ylver rreth fronit që gjantë
- 4 mbë të-paret me smaragdinë. Edhe përqark fronit ishinë njëzet e katrë frone; edhe mbë fronet (pashë) ndënjurë të njëzet e katrë pleqtë, veshurë me rroba të-bardha; edhe kishinë mbi krerët të tyre kurorë të-arta.
- 5 Edhe nga froni dilninë vetëtima e humbulima e zëra. Edhe përpara fronit ishinë shtatë lambadha zjarri të-ndezura, të-cilatë janë
- 6 të shtatë frymat' e Perëndisë. Edhe përpara fronit *ishte* një det i-qelqtë që gjante me krystall; edhe ndë mest të fronit edhe rrotullë fronit katrë shtëzë, që ishinë plot me
- 7 sy përpara e prapa. Edhe shtëz' e-parë gjante me leon, edhe shtëz' e-dytë gjante me viç, edhe shtëz' e-tretë e kishtë faqenë posi njeri, edhe shtëz' e-katërtë gjante me shqiponjë

- 8 që fluturon. Edhe të katrë shtëzëtë kishinë sicila veçan nga gjashtë krahë përqark, edhe përbrenda ishinë plot me sy; edhe nukë pushojnë dit' e natë dyke thënë, „Shënjt, shënjt, shënjt është Zoti, Perëndi Gjithëpushtëtësi,“ ay që ishte edhe që është edhe që vjen.
- 9 Edhe kur t'i apënë shtëzëtë lavdi e nder e të-falurë ndersë ati që ka ndënjurë mbi
- 10 front, që rron ndë jetët të jetëvet, Të njëzet e katrë pleqtë dotë bjenë përpara ati që ka ndënjurë mbi front, edhe dot' i falenë ati që rron ndë jetët të jetëvet, edhe dotë vënë kurorët' e tyre përpara fronit, dyke thënë,
- 11 I-vëjyerë je, o Zot, të marrç lavdin' e nderin' e fuqinë; sepse ti i kriove të-gjiitha, edhe për dashurimnë t'ënt janë, edhe ukriuanë.

**Krye 5.**

- 1 Edhe pashë mbë të-djathtët t'ati që kishte ndënjurë mbi front një vivli shkruarë përbrenda e përjashta, vulosurë me shtatë vula.
- 2 Edhe pashë një ëngjëll të-fortë dyke lëçiturë me zë të-math, Cili është i-zotj të hapnjë vivlinë edhe të sghithnjë vulat' e asaj? Edhe asndonjë nukë munte ndë qiellt, as mbi dhet, as ndënë dhet, të hapnjë vivlinë, as t'a shohë
- 4 atë. Edhe unë qanjam shumë, sepse asndonjë nuk' ugjënt i-zoti të hapnjë (e të këndonjë)
- 5 vivlinë, as t'a shohë atë. Edhe një nga pleq-

të më thotë, Mos qaj; ja tek munda leoni që është prej farës' së Judhësë, rrënja e Davidhit, të hapnjë vivlinë, edhe të sgrithnjë të shtatë vulat' e asaj.

- 6 Edhe pashë, edhe ja ndë mest të frontit edhe të katrë shtëzëvet, edhe ndë mest të pleqvet, një Qëng që po rrinte posi i-therurë, edhe që kishte shtatë brirë, edhe shtatë sy; të-cilëtë janë të shtatë frymat' e Perëndisë
- 7 që janë dërguarë mbë gjithë dhenë. Edhe erdhi e mori vivlinë prej së-dhjathtës' s'ati që kishte ndënjurë mbi front.
- 8 Edhe kur mori vivlinë, të katrë shtëzët' edhe të njëzet e katrë pleqtë ranë përpara Qëngjit, të-cilëtë kishinë gjithësicili qitharëra e kupa t'arta mbushurë me thimiamë, të-cilatë
- 9 janë të-falurat' e shënjtorëvet; Edhe këndonjë një kënkë të-re, dyke thënë, I-vëjyerë je të marrç vivlinë, edhe të hapç vulat' e asaj; sepse uthere, edhe na çpërbleve te Perëndia me gjakunë r'ënt, prej çdo fare e gjuhe e
- 10 llauzi e kombi; Edhe na bëre mbretër e priftër te Perëndia ynë; edhe dotë mbretërojmë mbi
- 11 dhet. Edhe pashë, edhe dëgjova një zë shumë ëngjëjsh përqark frontit edhe shtëzëvet edhe pleqvet; edhe numëri i atyreve ishte dhjetë-
- 12 mijëra dhjetë-mijërash, e mijëra mijërash, Që thoshuinë me zë të-math, I -vëjyer' është Qëngji i-therurë të marrë fuqin' e bekimnë.—Edhe çdo kriesë që është ndë qiellt e mbi

dhet, e ndënë dhet, e sa janë ndë dett, edhe gjithë sa *janë* nd' ato, dëgjova që thoshinë, Mb' atë që ka ndënjurë mbi front edhe mbë Qëngjinë *qoftë* bekimi e nderi e lavdia e pushteti ndë jetët

14 të jetëvet. Edhe të katrë shtëzëtë thoshinë, Amin; (edhe të njëzet e katrë) pleqtë ranë edhe i ufalnë (ati që rron ndë jetët të jetëvet).

## Krye 6.

- 1 Edhe pashë, kur hapi Qëngji njerënë nga vulatë, edhe dëgjova një nga të katrë shtëzëtë që thoshte, posi *me* zë bumbullime, Eja
- 2 edhe shih. Edhe pashë, edhe ja një kal' i-bardhë; edhe ay që kishte ndënjurë mbi atë kishte një hark; edhe i udha ati një kurorë, edhe dolli dyke mundurë, edhe që të muntnjë.
- 3 Edhe kur hapi vulën' e-dytë, dëgjova shtë-
- 4 zën' e-dytë, që thoshte, Eja (edhe shih). Edhe dolli një tjetërë kalë i-kuq; edhe ati që kishte ndënjurë mbi atë i udha të ngrerë paqtimnë nga dheu, edhe të thernjë njëri tjetërinë, edhe i udha ati një thik' e-madhe.
- 5 Edhe kur hapi vulën' e-tretë, dëgjova të-tretënë shtëzë që thoshte, Eja edhe shih. Edhe pashë, edhe ja një kal' i-zi, edhe ay që kishte ndënjurë mbi atë kishte një zigare një zigare ndë dorët të ti. Edhe dëgjova një zë ndë mest të katrë shtëzëvet që thoshte, Një shënik gruri për një dinar; edhe tre shënikë elbi për një dinar; edhe, Vajit edhe verësë mos i bëj dëm.

- 7 Edhe kur hapi vulën' e-katrëtë, dëgjova zën' e së-katrësë shtëzë që thoshte, Eja edhe  
 8 shih. Edhe pashë, edhe ja një kal' i-ligurë, edhe ay që kishte ndënjurë sipër' ati quhej Mortje, edhe Hadhi i vinte prapa bashkë, edhe udha ndër ata pushtet përmbi të- katrëtën' e dheut të vrasënë me shpatë e me zi *buke* e me vdekje, edhe me bishat' e dheut.
- 9 Edhe kur hapi vulën' e-pesëtë, pashë përposh theroresë shpirtërat' e atyreve që janë therurë për fjalën' e Perëndisë, edhe për  
 10 dëshmiminë që kishinë; Edhe thërrisininë me zë të-math, dyke thënë, Gjer kur, o Zotëni i-shënjtëruar' e i-vërtetë, nukë gjykon edhe nukë merr çpagiminë për gjakunë t'ënë nga  
 11 ata që rrinë mbi dhet? Edhe i udhanë gjithësicilit stolira të-bardha, edhe u utha atyrevë të prëhen' edhe pak kohë, gjersa të mbushen' edhe bashkëshërbëtorët' e atyreve, edhe vëllezërit' e atyreve, ata që janë për të vvarë sikundrë edhe ata.
- 12 Edhe pashë, kur hapi vulën' e-gjashtëtë; edhe ja tek ubë një tërmet i-math, edhe djelli ubë i-zi posi thes i-dhirë, edhe hëna u-  
 13 bë posi gjak; Edhe yjt' e qiëllit ranë mbë dhet, posi drur' i fikut që heth fiqt' e-paa-  
 14 rritë, kur tundetë prej ere së-madhe. Edhe qielli uhoq posi vivli kur pështiletë, edhe çdo mal e ujdhesë luajtnë nga vëndet' e tyre.
- 15 Edhe mbretërit' e dheut, e njerëzit' e-mëdhenj,

- e të-pasuritë, e kryemijësitë, e të-fortëtë, edhe çdo shërbëtuar, edhe çdo i-lirë, fshehnë vetëhen' e tyre ndëpër shpellat' e ndëpër  
 16 shkëmbënjt' e malevet, edhe u thonë malevet e shkëmbënjvet, Bini mbi ne, edhe fshih-na-ni nga faqeja e ati që ka ndënjurë mbi front,  
 17 edhe nga zëmërata e Qëngjit; Sepse erdhi dit' e-madhe e zëmëratës' s' ati; edhe cili munt të qëndronjë?

#### Krye 7.

- 1 Edhe pastaj pashë katrë ëngjëj që rrininë mbë të katrë çipat' e dheut, edhe mbaninë të katrë erërat' e dheut, që të mos frynte erë mbi dhet, as mbi dett, as mbë çdo dru.
- 2 Edhe pashë një tjetërë ëngjëll që hipi nga të-lindurit' e djellit e që kishte vulën' e Perëndis' së-gjallë; edhe u thërriti me zë të-math të katrë ëngjëjvet, të-cilëvet u udha t'  
 3 u bënë në dëm dheut edhe detit, E thoshte, Mos i bëni dëm dheut, as detit, as drurëvet, gjersa të vulosmë shërbëtorët' e Perëndisë t'ënë ndë ballët t'atyreve.
- 4 Edhe dëgjova numërin' e atyreve që u-vulosnë; një qint e dyzet e katrë mijë *ishinë* të-vulosurë prej gjithë faravet të bijvet të  
 5 Israilit; Prej farës' së Judhësë, dy-mbë-dhjetë mijë të-vulosurë; prej farës' së Rubinit, dy-mbë-dhjetë mijë të-vulosurë; prej farës' së  
 6 Gadit, dy-mbë-dhjetë mijë të-vulosurë; Prej

- farës' s' Ashirit, dy-mbë-dhjetë mijë të-vulosurë; prej farës' së Nefthaliut, dy-mbë-dhjetë mijë të-vulosutë; prej farës' së Manassehut, 7 dy-mbë-dhjetë mijë të-vulosurë; Prej farës' së Simeonit, dy-mbë-dhjetë mijë të-vulosurë; prej farës' së Leviut dy-mbë-dhjetë mijë të-vulosurë; prej farës' së Issaharit, dy-mbë-dhjetë mijë të-vulosurë; Prej farës' së Zabullonit, dy-mbë-dhjetë mijë të-vulosurë; prej farës' së Josifit, dy-mbë-dhjetë mijë të-vulosurë; prej farës' së Beniaminit, dy-mbë-dhjetë mijë të-vulosurë.
- 9 Pastaj pashë, edhe ja shumë gjindje, të-cilënë asndonjë s'muntte t'a numëronte, prej çdo kombi e farësh e llauzesh e gjuhërash, që rrininë përpara fronit e përpara Qëngjit, veshurë me stolira të-bardha, edhe mbaninë *dega*
- 10 hurmash ndër duart të tyre: Edhe thërrisninë me zë të-math, e thoshinë, Shpëtimi është i Perëndisë t'ënë qe ka ndënjurë mbi front edhe
- 11 i Qëngjit. Edhe gjithë ëngjëjtë rrininë për-qark fronit edhe pleqvet edhe të katrë shtë-zëvet, edhe ranë përmbys përpara fronit, e
- 12 i ufalné Perëndisë, Dyke thënë, Amin; bekimi e lavdia e dituria e të-faluritë ndersë e nderi e fuqia e forca është mbë Perëndinë t'ënë ndë jetët të jetëvet. Amin.
- 13 Edhe upërgjeq një nga pleqtë, e më tha, Cilëtë janë këta që janë veshurë me stolira të-
- 14 bardha, edhe nga erthnë? Edhe i thash' ati,

Zot, ti e di. Edhe më tha, Këta jan' ata që vinjënë prej shtrëngimit të-math; edhe lanë stolirat' e tyre, edhe sbarthnë stolirat' e tyre

15 ndë gjakt të Qëngjit. Përëndaj janë përpara fronit të Perëndisë, edhe e lusënë dit e natë

16 nde tempullt t'ati; edhe ay që ka ndënjurë mbi front ka për të ndënjurë ndërata. Nukë dotë kenë më uri, as nukë dotë kenë më et, as dotë bjerë djelli mbi ata, as çdo farë vape;

17 Sepse Qëngji që është ndër mest të fronit dot' i ruanjë ata e dot' u heqjë udhën' atyreve ndë burime ujërash të-gjalla; edhe Perëndia dotë fshinjë çdo lot nga syt' e atyreve.

#### Krye 8.

- 1 Edhë kur hapi të-shtattënë vulë, ubë ndë qiellt pushim sindonja gjysmë ore.
- 2 Edhe pashë të shtatë ëngjëjtë, të-cilëtë rrininë përpara Perëndisë edhe u udhanë atyreve shtatë trumbeta.
- 3 Edhe erdhi një tjetërë ëngjëll, edhe qëndroj mbi theroret, e mbante një tymtar të-artë; edhe i udhanë ati shumë thimjama, që t'i bjerë bashkë me të-falurat' e gjithë shënjtorëvet mbë theroren' e-artë që është përpara
- 4 fronit. Edhe hipi tymi i thimiamavet me të-falurat' e shënjtorëvet prej dorës' s' ëngjëllit
- 5 përpara Perëndisë; Edhe ëngjëlli mori tymtarinë, edhe e mbushi nga zjarri i theroresë

edhe e hodhi ndë dhet; edhe ubënë zëra e bumbullima e vetëtima e tërmet.

- 6 Edhe të shtatë ëngjëjtë që kishinë të shtatë trumbetatë ubënë gati që t'u bjenë trumbetavet.
- 7 Edhe ëngjëlli i-parë i ra trumbetësë, edhe ubë breshër e-zjarr përzierë me gjak, edhe uhothnë ndë dhet; edhe e-treta e drurëvet u-doq; edhe çdo bar i-njomë udoq.
- 8 Edhe ëngjëlli i-dytë i ra trumbetësë, edhe posi një mal i-math që digjetë me zjarr u-hoth ndë dett; Edhe e-treta e detit ubë gjak; edhe vdiq e-treta e kriesavet të-gjalla që ishinë nde dett; edhe e-treta e lundravet u-prish.
- 10 Edhe ëngjëlli i-tretë i ra trumbetësë, edhe ra nga qielli një yll i-math që digjej si llambadhë, edhe ra mbi të-tretën' e lumënjvet,
- 11 edhe mbi burimet' e ujëravet; Edhe emëri i yllit quhetë Apsinth; edhe e-treta e ujëravet ubë apsinth, edhe shumë njerës vdiqnë nga ujëratë, sepse uhidhëruanë.
- 12 Edhe ëngjëlli i-katrëtë i ra trumbetësë, edhe uplagos e-treta e djellit, edhe e-treta e hënësë, edhe e-treta e yjvet, që të errësonet' e-treta e atyreve, edhe dita të mos ndritnjë të-tretën' e saj, edhe nata gjithashtu.
- 13 Edhe pashë, edhe dëgjova një ëngjëll që fluturonte ndë mest të qiellit, që thoshte me zë të-math, Mjerë, mjerë, mjerë ata që rrinë

mbë dhet, për zëret' e-tjerë të trumbetës' së të tre ëngjëjvet që dot' u bjenë trumbetavet.

### Krye 9.

- 1 Edhe ëngjëlli i-pesëtë i ra trumbetësë, edhe pashë se një yll kishte rënë nga qielli mbi dhet, edhe i udha ati hapësi i pusit të pafundjesë. Edhe hapi pusin' e pafundjesë; edhe dolli tym nga pusi posi tym i një kamine së-madhe; edhe uerrësua djelli. edhe
- 3 era nga tymi i pusit. Edhe nga tymi duallë karkaleca mbi dhet, edhe u udha atyreve pu-shtet, sikundrë kanë përçollakët' e dheut. Edhe u utha atyreve të mos i bënënjë dëm barit të dheut, as ndonjëj njomësire, as ndonjëj druri, veç vetëmë njerësvet që s'kanë vulën' e Perëndisë ndë ballët të tyre.
- 5 Edhe u udha atyreve të mos i vrasën' ata, po të mundonenë pesë muaj; edhe mundimi i atyreve ishte posi mundim përçollaku, kur
- 6 çupit njerinë. Edhe nd' ato dit njerëzitë dotë kërkonjëne vdekjenë, edhe nukë dot'a gjenjëne; edhe dotë dëshëronjëne të vdesënë,
- 7 edhe vdekja dotë ikënënjë nga ata. Edhe nga forma karkalecatë u shëmbëllëninë kuajve që janë bërë gati për luftë; edhe mbi kërret' atyreve kishinë si kurora që gjaninë me ar, edhe faqet' e atyreve ishinë posi faqe njerë-zish. Edhe kishinë leshra posi leshra grash; edhe dhëmbët' e atyreve ishinë posi të leonë-

- 9 vet. Edhe kishinë thurakë posi thurakë të-  
hekurtë; edhe zëri i krahëvet t'atyre ishte po-  
si zë qeresh me shumë kuaj kur sulenë ndë  
10 luftë. Edhe kishinë bishtër që shëmbëlleninë  
me përçollakë, edhe thumba ishinë ndëpër  
bishtërit t'atyreve; edhe pushteti i atyreve ish-  
11 te t'u bënë në dëm njerësvet pesë muaj. Edhe  
kishinë mbret përmbi vetëhet të tyre ëngjë-  
llin' e pafundjesë; i-cili e ka emërinë Abadhon,  
edhe ndë Gërqshtet e ka emërinë Apolion  
[prishës].
- 12 Një mjerësi shkoj; ja tek po vinjënë e-  
dhe dy paskëtaj.
- 13 Edhe ëngjëlli i-gjashtë i ra trumbetësë, e-  
dhe dëgjova një zë nga të katër brirët' e the-  
14 rorës' s' artë që është përpara Perëndisë, Që  
i thoshte të-gjashtëit ëngjëll që kishte trum-  
betënë, Sgith të katër ëngjëjtë që janë li-  
15 dhurë mbë lumin' e-math Efrat. Edhe u-  
sgithnë të katër ëngjëjtë që ishinë bërë gati  
për orën' e për ditën' e për muajin' e për vi-  
tinë, që të vrasenë të-tretën' e njerësvet.
- 16 Edhe numëri i ushëtorëvet të kalorisë ishte  
17 dy dhjetë - mijëra dhjetë - mijërash. Edhe kë-  
shtu pashë kuajtë ndë të-pamët edhe ata  
që rininë mbi ata, se kishinë thurakë prej  
zjarri e prej jaqinthi e prej shqufuri; edhe  
krerët' e kuajvet *ishinë* posi krerë leonësh,  
edhe nga goj' e atyreve dilte zjarr e tym e  
18 shqufur. Nga këta të trë uvrinë e-treta e

- njerësvet, nga zjarri e nga tymi e nga shqu-  
19 furi që dilte nga gojët' e atyreve, Sepse pu-  
sttetet' e atyreve janë ndë gojët t' atyreve;  
sepse bishtërit' e atyreve shëmbëlleninë me  
gjërpënj, edhe kishinë krerë, edhe me ata  
20 bënë në dëm. Edhe njerëzit' e-tjerë, ata që  
nuk' uvrinë me këto plagë, as nuk' upen-  
duanë nga punërat' e duarvet të tyre, që të  
mos u falenë djajvet, e idhujvet të-artë e të-  
ergjëntë e të-ramtë e të-gurtë e të-drunjtë,  
të-cilëtë s' muntjnën' as të shohënë, as të  
21 dëgjonjënë, as të ecënjënë; Edhe nuk' upen-  
duanë nga vrasjet' e tyre, as nga magjit' e  
tyre, as nga kurvëria e tyre, as nga të-vje-  
dhurat' e tyre.

## Kyre 10.

- 1 Edhe pashë një tjarërë ëngëll të-fortë dy-  
ke sbriturë nga qielli, të-veshurë me re; edhe  
*kishte* ylver mbi kryet; edhe faqaja e ati  
*ishte* posi djelli, edhe këmbët' e ati posi shty-  
2 lla zjarri. Edhe kishte ndë dorët të ti një  
vivlizë të-hapurë; edhe vuri këmbën' e ti të-  
djathtënë mbi dett, edhe te-mëngjërënë mbi  
3 dhet. Edhe bërtiti me zë të-math posi leoni  
kur pëllet. Edhe kur bërtiti, folnë të shtatë  
4 bumbullimatë me zërat' e tyre. Edhe kur fol-  
në të shtatë bumbullimatë (me zërat' e tyre),  
kishnjam për të shkruarë; edhe dëgjova një  
zë nga qielli që (më) thoshte, Vulos ato që

- folnë të shtatë bumbulimatë, edhe mos i 5 shkruaj ato. Edhe ëngjëlli që pashë dyke ndënjurë mbi dett edhe mbi dhet ngriti dorën'
- 6 e ti mbë qiellinë, Edhe bëri be për atë që rron ndë jetët të jetëvet, i-cili krijoi qiellin' edhe sa janë nd' atë, edhe dhenë edhe sa janë nd' atë, edhe detinë edhe sa janë nd' atë, se 7 kohë nukë dotë jetë më; Po ndë ditt të zërit të ëngjëllit të-shtattë, kur dot' i bjerë trumbetësë, atëhere dotë mbaronetë fshehësir' e Perëndisë, sikundrë u'a kishte dhënë zën' e-mirë shërbëtorëvet të ti profitër.
- 8 Edhe ay zëri që dëgjova nga qielli, përsëri fliste me mua, e thoshte, Shko, e merr vlvizën' e-hapurë ndë dorët t' ëngjëllit 9 që ka ndënjurë mbi dett e mbi dhet. Edhe vajta tek ëngjëlli, e i thashë, Ep-më vlvizënë. Edhe ay më thotë, Merr-e, edhe haj-e atë; edhe dotë hidhëronjë barkunë t' ënt, po ndë gojët t' ënde dotë jet' e-ëm- 10 bëllë posi mjaltë. Edhe mora vlvlizënë nga dor' e ëngjëllit, edhe e hëngra; edhe ishte ndë gojët t' ime e-ëmbëllë posi mjaltë; edhe kur e hëngra atë, uhidhërua barku im.
- 11 Edhe më thotë, Duhetë të profitepç përsëri për shumë llauze e kombe e gjuhëra e mbretër.

## Krye 11.

- 1 Edhe m'udha një kallam që gjante me shkop; edhe ëngjëlli rrinte e më thoshte,

- Ngreu, edhe mat tempullin' e Perëndisë, edhe therorenë, edhe ata që falenë nd' atë.
- 2 Po avillinë që është përjashta tempullit lër-e jashtë, edhe mos e mat, sepse udha ndër kombet; edhe qytetin' e-shënjtëruarë dot'a shkelnjënë dyzet e dy muaj.
- 3 Edhe dot' u ap të dy dëshmitarëvet të mi, edhe dotë profitepsnjënë një mijë e dy qint e gjashtë-dhjetë dit, veshurë me thasë.
- 4 Këta janë të dy drurët' e ullirit, edhe të dy kandiletë që rrinë përpara Perëndisë' së dheut.
- 5 Edhe ndë dashtë ndonjë t'u bënë dëm atyreve, zjarr del nga goj' e atyreve, edhe ha armiqt' e atyreve; edhe ndë dashtë ndonjë t' u bënë dëm atyreve, kështu duhetë të vritet' 6 ay. Këta kanë pushtet të mbyllnjënë qiellinë, që të mos bjerë shi ndë ditt të profitis' s' atyreve; edhe kanë pushtet mbi ujërat t' i kthenjënë mbë gjak, edhe t'i bjenë dheut me çdo farë plage, sa herë të duanë.
- 7 Edhe kur të mbaronjënë dëshmimn' e tyre, bisha që del nga pafundja dotë bënë luftë me ata, edhe dot' i muntnjë, edhe dot' i vrasë.
- 8 Edhe kufomat' e atyreve dotë *dergjenë* mbi rugët të qytetit të-math, që quhetë shpirtë-rish Sodhomë edhe Egjyptë, ku edhe Zoti ynë ukryqëzua.
- 9 Edhe prej llauzëvet e prej faravet e prej gjuhëravet e prej kombevet *shume veta* dot' i shohënë kufomat' e atyreve tri dit e gjys-

- më, edhe nukë dotë lënë kufomat' e atyreve
- 10 të vihenë ndë varre. Edhe ata që rrinë mbi dhet dotë gëzonenë për ata, edhe dotë gasmonenë; edhe dotë dërgonjënë dhurëtira njëri tjetërit; Sepse këta të dy profitër munduan' ata që rrinë mbi dhet.
- 11 Edhe pas tri dit e gjysmë hyri mb' ata frymë jete prej Perëndisë; edhe qëndruanë mbë këmbët të tyre, edhe i mori frik' e-ma-
- 12 dhe ata që i shihninë. Edhe dëgjuanë një zë të-math nga qielli që u thoshte atyreve, Hipni këtu. Edhe hipnë ndë qiell mbë ret;
- 13 edhe armiqt' e atyreve i panë ata. Edhe nd' atë orë ubë një tërmet i-math, edhe e-dhjetta e qytetit ra, edhe uvrane ndë tërmett shtatë mijë emëra njerëzish; edhe të-tjerët' i mori frika, edhe i dhanë lavdi Perëndis' së qiellit.
- 14 E-dyta mjerë shkoj: ja tek po vjen çpejt e-treta mjerë.
- 15 Edhe i-shtatti ëngjëll i ra trumbetësë, edhe ubënë zëre të-mëdhenj ndë qiell që thoshinë, Mbretërirat' e botës' ubënë te Zotit t' ënë, edhe të Krishtit t' ati, edhe dotë mbretëronjë ndë jetët të jetëvet.
- 16 Edhe të njëzet e katër pleqtë që rrininë përpara Perëndisë mbi fronat të tyre ranë me faqe përdhe, edhe i ufalnë Perëndisë,
- 17 Dyke thënë, Të falemi ndersë ty, o Zot, Perëndi Gjithëpushtetës, *i-cili je ay që është edhe ay që ishte* (edhe ay që vjen); sepse

- more fuqinë t' ende të-madhe, edhe mbretërovë; Edhe kombet' uzëmëruanë, edhe erdhi zëmërata jote, edhe koha e të-vdekuret, që të gjykonenë, edhe t' u apç pagënë shërbëtorëvet të tu profitër, edhe shënjtorëvet, edhe atyreve që i kanë frikë emërit t' ënt, të-vegjëlvet e të-mëdhenjvet, edhe të prishç ata që prishnjënë dhenë.
- 19 Edhe uhap tempulli i Perëndisë ndë qiellt, edhe uduk arka e dhjatës' s' ati ndë tempullt t' ati; edhe ubënë vetëtima e zëra e bum-bullima e tërmet e breshër i-math.

## Krye 12

- 1 Edhe uduk një shënj' e-madhe ndë qiellt; një grua që kishte veshurë djellinë, edhe hëna ishte përposh këmbëvet t' asaj, edhe mbi kryet t' asaj *ishte* një kurorë dy-mbë-dhjetë
- 2 yjsh; Edhe passi ishte me barrë, bërtiste nga të-dhëmburat' e barkut, e mundonej për të pjellë.
- 3 Edhe uduk një tjetërë shënjë ndë qiellit, edhe ja një dragua i-math e i-kuq, i-cili kishte shtatë krerë e dhjetë brirë; edhe mbi krerët t' ati shtatë kurorë; Edhe bishti i ati hiqte të-tretën' e yjvet të qiellit, edhe i hodhi ata ndë dhet. Edhe dragoj ndënji përpara gruasë që kishte për të pjellë, që të
- 5 hante të birin' e asaj, kur te pillfe. Edhe polli një djalë mashkull, i-cili ka për të ku-

- lloturë gjithë kombetë me shkop të-hekurtë; edhe djal' i asaj urrëmye te Perëndia edhe te fron' i ati. Edhe gruaja iku ndë shkretëtirët, ku kishte vënt të bërë gati nga Perëndia, që t'a ushqenjë në atje një mij' e dy qint e gjashtë-dhjetë dit.
- 7 Edhe ubë luftë ndë qiellit; Mihaili edhe ëngjëjt' e ati luftuanë kundrë dragojt, edhe
- 8 dragoj luftoj, edhe ëngjëjt' e ati. Edhe nukë muntë, as ugjënt vënt për ata ndë qiellit.
- 9 Edhe uhoth poshtë dragoj i-math, gjarpëri i-moçim që quhetë djall, edhe Satanaj, ay që kobon gjithë botënë, uhoth poshtë ndë dhet, edhe ëngjëjt' e ati uhothnë *poshtë* bashkë me
- 10 atë. Edhe dëgjova një zë të-math që thoshte ndë qiellit, Tashi ubë shpëtimi edhe fuqia edhe mbretëria e Perëndisë t' ënë, edhe pushteti i Krishtit t' ati; sepse uhoth *poshtë* përfolësi i vëllezërvet t'anë, ay që përflet ata
- 11 përpara Perëndisë t'ënë nat' e ditë. Edhe ata e muntë atë për gjakun' e Qëngjit, edhe për fjalën' e dëshmimit të tyre; edhe nuk' e desh-
- 12 në jetën' e tyre gjer mbë vdekje. Përandaj gëzohuni, o qiej, edhe ju që rriini nd-ata. Mjerë (ata që rrinë) ndë dhet e nde dett, se sbriti djalli te ju, dyke pasurë zëmërim të-math, sepse e di se ka pak kohë.
- 13 Edhe kur pa dragoj se uhoth *poshtë* ndë
- 14 dhet, ndoqi gruanë që polli mashkullinë. Edhe i udhanë gruasë dy krahë të shqiponjës'

- së-madhe, që të fluturonjë ndë shkretëtirët ndë vëntt të saj, ku ushqenetë kohë edhe kohëra edhe gjysmë kohe, *lark* nga faqeja e
- 15 gjarpërit. Edhe gjarpëri lëshoj prapa gruasë nga goja e ti ujë posi lumë, që të bënë që
- 16 t'a marrë atë lumi. Edhe dheu i ndihu gruasë, edhe dheu hapi gojën' e ti, edhe e përpiu
- 17 luminë që lëshoj dragoj nga goj' e ti. Edhe dragoj uzëmërua kundrë gruasë, edhe vate të bënë luftë bashkë me të-tjerët' e farës' s, asaj që ruanjë në porosit' e Perëndisë edhe që kanë dëshmimn' e Jisu (Krishtit).

## Krye 13.

- 1 Edhe ndënja mbi rërët të detit; edhe pashë një bishë që dilte nga deti, që kishte shtatë krerë, e dhjetë brirë; edhe mbi brirët t' asaj dhjetë kurorë, edhe mbi krerët t' asaj një emërë *vllasfemie*. Edhe bisha që pashë shëmbëllente me pardhall, edhe këmbët' e asaj ishinë posi t'ariut, edhe goj' e asaj posi gojë leoni; edhe dragoj i dha asaj fuqin' e ti, edhe fronin' e ti, edhe pushtet të-
- 3 math. Edhe (pashë) një nga krerët' e asaj posi të-plagosurë për vdekje; edhe plaga e asaj për vdekje ushërua; edhe gjithë dheu uçudit
- 4 prapa bishësë. Edhe i ufalné dragojt që i dha pushtet bishësë, edhe i ufalné bishësë, dyke thënë, Kush i gjan bishësë? Kush munt të luftonjë me atë?

- 5 Edhe i udha asaj gojë që flet *fjal*<sup>2</sup> të-  
 6 mëdha edhe vllasfimira, edhe i udha asaj pu-  
 shtet të bënjë luftë dyzet e dy muaj. Edhe ha-  
 pi gojën' e saj mbë vllasfimi kundrë Perën-  
 disë, që të vllasfimisnjë emërin' e ati, edhe  
 tendën' e ati, edhe ata që rrinë ndë qiellit.  
 7 Edhe i udha asaj të bënjë luftë me shënjto-  
 rëtë, edhe t'i muntnjë; edhe i udha asaj pu-  
 8 shtet përmbi çdo farë e gjuhë e komp. Edhe  
 dot' i falen' asaj gjith' ata që rrinë mbi dhet,  
 emërat' e të-cilëvet nukë janë shkruarë ndë  
 vivlit të jetës' së Qëngjit që është therurë që-  
 9 kur se është ngrehurë bota.—Kush ka vesh,  
 10 letë dëgjonjë.—Kush të bjerë *tjatërinë* ndë  
 skllavëri, ndë skllavëri dotë vejë; kush të  
 vrasë me thikë, duhetë edhe ay të vritetë me  
 thikë. Këtu është durimi edhe besa e shën-  
 torëvet.
- 11 Edhe pashë një tjetërë bishë që dilte nga  
 dheu, edhe kishte dy brirë që shëmbëlleninë  
 12 me *brirë* qëngji, edhe fliste si dragua. Edhe  
 bënte gjithë pushtetin' e bishës' së-parë për-  
 para asaj; edhe bënte dhenë edhe ata që rrinë  
 mb' atë t'i falenë bishës' së-parë, së-cilësë  
 13 plaga për vdekje i ushërua. Edhe bënte shë-  
 nja të-mëdha, kaqë sa edhe zjarr bënte të  
 sbresë nga qielli mbi dhet përpara njerësvet.  
 14 Edhe kobonte ata që rrininë mbi dhet, për  
 shënjatë që i udhanë asaj të bënjë përpara  
 bishësë, e u thoshte atyreve që rrininë mbi

- dhet t'i bënjën' ikonë bishësë që kishte pla-  
 15 gën' e thikësë, edhe rroj. Edhe i udha asaj t'i  
 apë frymë ikonës' së bishësë, kaqë sa edhe  
 të flasë ikon' e bishësë, edhe të bënjë që të  
 vriten' ata që s' i falen' ikonës' së bishësë.  
 16 Edhe bënte të-gjithë, të-vegjëlit' e të-më-  
 dhenjtë, edhe të-pasurit' edhe të-vobeqtë, edhe  
 të-lirët' edhe shërbëtorëtë, të marrënë një *shë-  
 një* të-gërvishturë mbë dorën' e tyre të-djath-  
 17 të, a mbë ballërat' e tyre; Edhe që të mos  
 muntte ndonjë të blerë a të shesë, përveç  
 ay që ka të-gërvishturitë, a emërin' e bishësë,  
 18 a numërin' e emërit t' asaj. Këtu është ditu-  
 ria; ay që ka mëndjenë *ndë kokë* letë bënjë  
 llogari numërin' e bishësë; sepsë është numër  
 njeriu, edhe numër' i asaj është gjashtë qint e  
 gjashtë-dhjet' e gjashtë.

## Krye 14.

- 1 Edhe pashë, edhe ja një Qëng tek rrinte mbi  
 malt Sion, edhe bashkë me atë *ishinë* njëqint  
 e dyzet e katër mijë që kishinë emërin' e Atit  
 2 t'ati të-shkruarë mbë ballërat' e tyre. Edhe dë-  
 gjova një zë nga qielli posi zë shumë ujërash,  
 edhe posi zë bumbullime së-madhe; edhe dë-  
 gjova një zë qitharorësh që qitharisninë me  
 3 qitharat' e tyre. Edhe këndoninë (posi) një  
 kënkë të-re përpara fronit, edhe përpara të  
 katër shtëzëvët edhe pleqvet; edhe asndonjë  
 s' muntte të merrte vesh kënkënë, veç të një

- qint e dyzet e katër mijtë, që ishinë blerë  
 4 prej dheut. Këta jan' ata që nuk' undyrnë me  
 gra, sepse janë të-virgjërë; këta jan' ata që  
 i venë prapa Qëngjit kudo që të vejë; këta  
 ublenë nga njerëzitë, që të jenë pem' e-parë  
 5 te Perëndia edhe te Qëngji. Edhe ndë gojë  
 t' atyre nuk' ugjënt kobim, sepse janë pa të-  
 metë (përpara frontit të Perëndisë).
- 6 Edhe pashë një tjetër' ëngjëll dyke flutu-  
 ruarë ndë mest të qiellit, i-cili kishte ungji-  
 llin' e-përjetëshm, që t'ungjillëzonjë mb' ata  
 që rrinë mbi dhet, edhe mbë' çdo komp e  
 7 farë e gjuhë e llaus; E thoshte me zë të-  
 math, Kini frikë Perëndisë, edhe epni lavdi  
 ati, sepse erdhi ora e gjyqit t'ati; edhe i u-  
 falni ati që bëri qiellin' e dhen' e detin' e bu-  
 rimet' e ujëravet.
- 8 Edhe një tjetër' ëngjëll vate prapa, e  
 thoshte, „Ra, ra Babillona,“ (qytet') i-math;  
 sepse ujiti gjithë kombetë me verën' e zëmë-  
 rimit të kurvëris' së saj.
- 9 Edhe një ëngjëll i-tretë vate prapa aty-  
 reve, dyke thënë me zë të-math, Kush t'i fa-  
 letë bishës' edhe ikonës' s' asaj, edhe të-marrë  
 të-gërvishturë mbë ballën' e ti a mbë dorën'  
 10 e ti, Edhe ay dotë pijë nga vera e zëmëri-  
 mit të Perëndisë, që është derdhurë e-papër-  
 zjerë ndë potirt të zëmërimit t'ati; edhe dotë  
 mundonetë me zjarr e me squfur përpara ën-  
 gjëjvet të-shënjtëruar' edhe përpara Qëngjit.

- 11 Edhe tymi i mundimit t' atyreve hipën ndë  
 jetët të jetëve; edhe s'kanë të-prëjturë dit'  
 e natë ata që i falenë bishësë edhe ikonës'  
 s'asaj, edhe ay që merr të-gërvishturit' e e-  
 12 mërit t'asaj. Këtu është durimi i shënjtorë-  
 vet; këtu jan' ata që ruanjënë porosit' e Pe-  
 rëndisë edhe besën' e Jisujt.
- 13 Edhe dëgjova një zë nga qielli që (më)  
 thoshte, Shkruaj, Të-lumurë që tani jan' ata  
 të-vdekurë që vdesënë mbë Zotinë. Po, thotë  
 Fryma, që të prëhenë nga mundimet' e tyre;  
 edhe punërat' e atyre u venë prapa, bashkë  
 me ata,
- 14 Edhe pashë, edhe ja një re e-bardhë, edhe  
 mbi ret kishte ndënjurë një që shëmbëllente  
 me bir njeriu, edhe kishte mbi kryet të ti një  
 kurorë t'artë, edhe ndë dorët të ti një dra-  
 15 për të-prehëtë. Edhe një tjetër' ëngjëll doli  
 nga tempulli dyke thërriturë me zë të-math  
 mb' atë që kishte ndënjurë mbi ret, Dërgo  
 drapërinë t'ënt, edhe korr; sepse (të) erdhi  
 ora të korrç, sepse utha të-korrët' e dheut.
- 16 Edhe ay që kishte ndënjurë mbi ret vuri dra-  
 përin' e ti mbi dhet; edhe dheu ukorr.
- 17 Edhe një tjetër' ëngjëll doli nga tempulli  
 që ishte ndë qiellit, dyke pasur' edhe ay një  
 18 drapër të-prehëtë. Edhe një tjetër' ëngjëll doli  
 nga theroreja, i-cili kishte pushtet mbi zjarrt;  
 edhe thërriti me zë të-math mb' atë që kishte  
 drapërin' e-prehëtë, dyke thënë, Dërgo drapë-

rinë t'ënt të-prehëtë, edhe vil rrusht' e veshitit të dheut, sepse uarrinë rrusht' e ati. Edhe ëngjëlli vuri drapërin' e ti ndë dhet, edhe voli veshitin' e dheut, edhe hodhi rrushtë ndë tirët 20 të-madhe të zëmërimin të Perëndisë. Edhe tira ushtyp përjashta qytetit, edhe dolli gjak nga tira gjer mbë frenjt të kuajvet, ndë një vënt një mijë e gjashtë qint stadhesh.

#### Krye 15.

- 1 Edhe pashë një tjetërë shënjë ndë qiellit të-madh' e të-çudiçime, shtatë ëngjëj, të-cilëtë kishinë të shtatë plagët' e-pastajme, sepse mb' ato umbarua zëmërimi i Perëndisë.
- 2 Edhe pashë posi një det të-qelqtë të-përzjerë me zjarr; edhe ata që muntënë bishën' edhe ikonën' e asaj, (edhe shënjën' e asaj,) edhe numërin' e emërit t'asaj, që po rrininë mbi detin' e-qelqtë, edhe kishinë qitharat' e 3 Perëndisë; Edhe këndoninë kënkën' e Moisiut, shërbëtorit të Perëndisë, edhe kënkën' e Qëngjit, dyke thënë, Të-mëdha e të-çudiçime janë punët' e tua, o Zot, Perëndi Gjithëpushtetës; të-drejta edhe të-vërteta janë udhët' e 4 tua, o mbret i shënjtorëve. Cili nukë dotë të ketë frikë ty, o Zot, edhe nukë dotë lavduronjë emërinë t'ënt? sepse ti vetëmë je shënjt; sepse gjithë kombetë dotë vinjënë, e dotë falenë përpara teje; sepse gjyqet' e tu uçpërfaqnë.

- 5 Edhe pastaj pashë, edhe ja tek uhap tem- 6 pulli i tendës' së dëshmimit ndë qiellit. Edhe duallë nga tempulli të shtatë ëngjëjtë, që kishinë të shtatë plagëtë, veshurë me li të-pastrët' e të-ndriçim, edhe ngjeshurë rreth krah-rorëvevet breza t'artë.
- 7 Edhe një nga të katrë shtezëtë u dha të shtatë ëngjëjvet shtatë botila t'arta mbushurë me zëmërimin' e Perëndisë që rron ndë jetët të jetëvevet.
- 8 Edhe tempulli umbush me tym nga lavdia e Perëndisë, edhe nga fuqia e ati; edhe asndonjë nukë munte të hynte ndë tempullit, gjer sa të mbaroneshinë të shtatë plagët' e të shtatë ëngjëjvet.

#### Kyre 16.

- 1 Edhe dëgjova një zë të-math nga tempulli qe u thoshte të shtatë ëngjëjvet, Shkoni e derthni botilat' e zëmërimin të Perëndisë mbi dhet.
- 2 Edhe vate i-pari, edhe derdhi botilen' e ti mbi dhet; edhe ubë një plag' e-keqe edhe e-ligë mb' ata njerëzitë që kishinë të-gërvishurit' e bishësë, edhe mb' ata që i faleshin' ikonës' s' asaj.
- 3 Edhe i-dyti ëngjëll derdhi botilen' e ti ndë dett edhe ubë gjak posi gjak të-vdekuri; edhe çdo frym' e gjallë që ishte ndë dett vdiq.
- 4 Edhe i-treti ëngjëll derdhi botilen' e ti

- ndëpër lumënt e ndëpër burimet të ujëravet;  
 5 edhe ubë gjak.—Edhe dëgjova ëngjëllin' e ujëravet që thoshte, I-drejtë je ti, (o Zot,) që je ay që është edhe që ishte edhe Shënji, sepse gjykove këto. Sepse derdhnë gjak shënjtorësh edhe profitërsh, edhe gjak u dhe atyreve të pinë; sepse u vëjen atyreve. — Edhe dëgjova (një tjetërë) nga theroreja që thoshte, Po, o Zot, Perëndi Gjithëpushtetës, të-vërtetë edhe të-drejtë janë gjyqet' e tu.
- 8 Edhe i-katërti ëngjëll derdhi botilen' e ti mbi djellët; edhe i udha ati të djegë njerëzitë me zjarr. Edhe njerëzitë udoqnë me një të-djegurë të-math, edhe shanë emërin' e Perëndisë që ka pushtet mbi këto plagë; edhe nuk' upenduanë që t'i apënë lavdi ati.
- 10 Edhe i-pesëti ëngjëll derdhi botilen' e ti mbi front të bishësë; edhe uerrësua mbretëria e asaj; edhe përtrypninë gjuhët' e tyre
- 11 nga të-dhëmburitë; Edhe shanë Perëndin' e qiellit për të-dhëmburat' edhe për plagët' e tyre, edhe nuk' upenduanë nga punërat' e tyre.
- 12 Edhe i-gjashtëti ëngjëll derdhi botilen' e ti mbi lumin' e-math Efrat; edhe ujët' e ati utha, që të bënetë gati udha e mbretërvet
- 13 që janë nga të-lindurit' e djellit. Edhe pashë tri fryma të-ndyra që shëmbëlleninë mbë bretkosa, që *dilninë* nga goja e bishësë, edhe
- 14 nga goja e profitit gënjeshtar; Sepse janë

- fryma djajsh që bënëjnë shënja, të-cilatë venë te mbretërit' e (dheut edhe të) gjithë botësë, që të mbledhën' ata për luftën' e asaj ditës' së-madhe të Perëndisë Gjithëpushtetës.
- 15 (Ja tek vinj posi vjedhës; lum ay që rri sguarë, edhe ruan rrobat' e tia, që të mos ecënjë sveshurë, e të shohënë të-shëmtuarët' e
- 16 ati.) Edhe i mbloodhi ata nd' atë vënt që quhetë Ebraisht Armagjeddon.
- 17 Edhe i-shtatëti ëngjëll derdhi botilen' e ti nd' erët; edhe dolli një zë i-math nga tempulli i qiellit, nga froni, që thoshte, Umba-
- 18 rua. Edhe ubënë zëra e bumbullime e vetëtima, edhe ubë një tërmet i-math, që i-atillë nuk' është bërë që kur se kanë qënë njerëzitë mbi dhet, një kaqë fort i-math tërmet.
- 19 Edhe qyteti i-math unda mbë tri pjesë, edhe qytetet' e kombevet ranë. Edhe erdhi ndë kujtim përpara Perëndisë Babilona e-madhe, që t'i apë kupën' e verës' së zëmërimit të zëmë-
- 20 ratës' së ti. Edhe çdo ujdhesë iku, edhe ma-
- 21 letë s'ugjëtnë. Edhe një breshër i-math posa një tallant sbriti nga qielli mbi njerëzit; edhe njerëzitë shaninë Perëndinë për plagën' e breshërit, sepse plag' e ati ishte fort e-madhe.

## Krye 17.

- 1 Edhe erdhi një nga *ata* të shtatë ëngjëjtë që kishinë të shtatë botilatë, edhe foli bashkë me mua, e më tha, Eja, dotë të dëftenj

gjqin' e kurvës' së-madhe që ka ndënjurë  
 2 mbi ujërat të-shuma; Me të-cilënë kurvëruanë  
 mbretërit' e dheut, edhe udejtne ata që rrinë  
 3 mbi dhet nga vera e kurvëris' s'asaj. Edhe më  
 shpuri me frymë ndë një vënt të-shkretë;  
 edhe pashë një grua që po rrinte mbi një  
 bishë të-kuqe, që ishte plot me emëra vlla-  
 sfimie, që e kishte shtatë krerë e dhjetë brirë.  
 4 Edhe gruaja ishte veshurë me porfirë e me  
 të-kuq, edhe përruarë me ar e me gurë të-  
 çëmuarë e me margaritarë, e kishte ndë dorët  
 të saj një kupë të-artë mbushurë me ndyrë-  
 5 sira e më pëgërësira të kurvëris' së saj; Edhe  
 mbë ballët t' asaj ishte shkruarë një emër,  
*Fshehësirë, Babillona e-madhe, nëna e kurvavet*  
 6 *edhe të ndyrësiravet të dheut.* Edhe pashë  
 gruanë dyke udejturë nga gjaku i shënjtorë-  
 vet, edhe nga gjaku i dëshmimtarëvet të Ji-  
 sujt. Edhe kur e pashë atë, uçudita me çudi  
 të-madhe.  
 7 Edhe ëngjëlli më tha, Përse uçudite? unë  
 dotë të them tyj fshehësirën' e gruasë, dhe  
 të bishësë që mban atë, e-cila ka të-shtatë  
 8 krerët' e të dhjetë brirëtë. — Bisha, të-cilënë  
 pe, ishte, edhe nuk' është, edhe dotë dalë nga  
 pafundja, edhe dotë vejë ndë humbje; edhe  
 dotë çuditen' ata që rrinë mbi dhet, emërat'  
 e të-cilëvet nukë janë shkruarë ndë vivlit të  
 jetësë që kur është ngrehurë bota, kur të sho-  
 hënë atë bishënë që ishte, edhe nuk' është,

9 ndonëse është. Këtu është mëndja që ka dituri.  
 Të shtatë krerëtë janë shtatë male, ku rri gru-  
 10 aja mbi ata. Edhe janë shtatë mbretër; të  
 pesëtë ranë, edhe njëri është, edhe tjetëri e-  
 dhe s'ka ardhurë; edhe kur të vinjë, pak ko-  
 11 hë duhetë të mhetetë. Edhe bisha që ishte,  
 edhe nuk' është, edhe ky është i-tetti *mbret*,  
 edhe është nga të-shtatëtë, edhe vetë ndë  
 12 humbje. Edhe të dhjetë brirëtë që pe, janë  
 dhjetë mbretër, të-cilëtë edhe s'kanë marrë  
 mbretëri, po marrënë pushtet posi mbretër një  
 13 orë bashkë me bishënë. Këta kanë një mëndje,  
 edhe dotë apënë ndë dorët të bishësë fuqin'  
 14 edhe pushtetin' e tyre. Këta dotë luftonjënë  
 me Qëngjinë, edhe Qëngji dot' i muntnj' ata,  
 sepse është Zot i zotërvet edhe Mbret i mbre-  
 tërvet; edhe ata që janë bashkë me atë janë  
 të-thërritur' e të-sqjedhur' e besëtarë.  
 15 Edhe më thotë, Ujëratë që pe atje ku rri  
 kurva, janë llauze e gjindje, e kombe e gju-  
 16 hëra. Edhe të dhjetë brirëtë, të-cilëtë pe mbi  
 bishët, këta dot' i kenë cmir kurvësë, edhe  
 dot'a bënëjën' atë të-shkretë edhe lakuriq, e-  
 dhe dotë hanë mishrat' e asaj, edhe atë dot'a  
 17 djegënë ndë zjarr. Sepse Perëndia dha ndë  
 zëmërat t'atyreve të bënëjënë mëndjen' e ati,  
 edhe të bënenë me një mëndje, edhe mbre-  
 tërin' e tyre t'ja apënë bishësë, gjersa të-  
 18 mbaronenë fjalët' e Perëndisë. Edhe gruaja

që pe është qyteti i-math që ka mbretëri mbi mbretërit të dheut.

## Krye 18.

- 1 Edhe pastaj pashë një ëngjëll dyke sbriturë nga qielli, që kishte një pushtet të-math;
- 2 edhe dheu undrit prej lavdis' s' ati. Edhe bërtiti (fort) me zë të-math, dyke thënë, „Ra, ra Babillona,, e-madhe, edhe ubë të-ndënjurit'e djajvet, edhe shtrofka e çdo fryme së-ndyre, edhe shtrofka e çdo farë shpesi të-ndyrë e të-mërziturë. Sepse nga vera e zëmërimt të kurvëris' s' asaj pinë gjithë kombetë, edhe mbretërit'e dheut kurvëruanë bashkë me atë, edhe tregëtarët'e dheut ubënë të-pasurë nga të-tëpërit'e shëfrimit t'asaj.
- 4 Edhe dëgjova një tjetërë zë nga qielli që thoshte, Dini prej asaj, llauzi im, që të mos keni pjesë ndër fajet t'asaj, edhe të mos merrni nga plagët'e asaj; Sepse fajet'e asaj arritnë gjer mbë qiellit, edhe Perëndia kujtoj
- 6 paudhërit'e asaj. Çpagua-j'a-ni asaj, sikundrë edhe ajo u'a çpagoj (juve), edhe j'a çpaguani për një dy pas punëravet t'asaj; me kupënë, me të-cilënë shtyri, shtini-i asaj për
- 7 një dy. Sa lavduroj vetëhen'e saj edhe ukënaq ndë shëfrimet, kaqë mundim e vajë ep-ini asaj; sepse fhotë me zëmëren' e saj, Po rri mbretëshë, edhe nukë jam e-ve, edhe
- 8 s' kam për të parë vajë.—Përandaj mbë një

ditë dotë vinjënë plagët' e asaj, vdekje edhe vajë edhe zi buke; edhe dotë digjetë ndë zjarr, sepse i-fortë është Zoti, Perëndia, që gjykon atë.

- 9 Edhe dotë qanjënë për atë edhe dotë mbanjënë zi për atë mbretërit' e dheut, ata që kurvëruan' edhe shëfryenë bashkë me atë, kur të shohënë tymin' e të-djegurit t' asaj.
- 10 Dyke ndënjurë prej së-largu, nga frika e mundimit t' asaj, e dyke thënë, Mjere, mjerë ti qyteti i-math, Babillona, qyteti i-fortë, sepse për një orë erdhi gjyqi yt.
- 11 Edhe tregëtarët' e dheut qanjënë e bënëjënë vajë për atë, sepse asndonjë nukë ble më
- 12 barrët' e atyreve; Barrë ari e ergjëndi, e gurësh të-çëmuarë, e margaritarësh, e pëlhure së-hollë, e porfire, e mëndafshi e të-kuqeje; edhe çdo dru me erë të-mirë, e çdo enë prej kokalle elefandi, e çdo enë prej druje së-paçëmuarë, e rame, e hekuri, e mermeri;
- 13 Edhe kanellë, e thimiamëra, e vaj ere, e livan, e verë, e vaj, e atherë mjelli, e grurë, e bagëti, e dhën, e kuaj, e qere, e skilevër, e
- 14 shpirtëra njerëzish. Edhe pemët' e dëshërimt të shpirtit t'ënt iknë prej teje, edhe gjithë të-majmet' edhe të-ndrituratë iknë prej teje, e-
- 15 dhe më nukë dot' i gjenç. Tregëtarët' e këtyre, që ubënë të-pasurë nga ajo, dotë rrinë prej së-largu për frikën' e mundimit t'asaj,
- 16 dyke qarë e dyke bërë vaje, E dyke thënë,

Mjerë, mjerë qyteti i-math, që ishte vëshurë me vishnje e me porfirë e me të-kuqe, edhe përruarë me ar e me gurë të-çëmuarë e me margaritarë; sepse për një orë ushkretua gjithë këjo pasje.

- 17 Edhe çdo zot anie, edhe gjithë sumica që është mbi aniat, e detarë, e gjithë sa puno-  
 18 njënë detinë, ndënjnë prej së-largu, Edhe bërtisinë, kur shihninë tymin' e të-djegurit t'asaj, dyke thënë, Cili qytet ka qënë posi ky  
 19 qytet i-math? Edhe hothnë pluhur mbi kre-  
 rët të tyre, edhe bërtisinë dyke qarë e dy-  
 ke bërë vajë, e thoshninë, Mjerë, mjerë qy-  
 teti i-math, nde të-cilët ubënë të-pasurë nga  
 pasja e asaj gjith' ata që kishninë ania ndë  
 dett, sepse për një orë ushkretua.  
 20 Gëzohu për atë, o qiell, edhe ju apostojt'  
 e shënjtëruarë edhe profitëritë, sepse Perën-  
 dia gjykoj gjyqinë t'uaj kundrë asaj.  
 21 Edhe një ëngjëll i-fortë ngriti një gur po-  
 si gur mulliri të-math, edhe e hodhi ndë dett,  
 dyke thënë, Kështu dotë hidhetë me fërtynë  
 Babillona, qyteti i-math, edhe nukë dotë gjën-  
 22 detë më. Edhe zë qitharorësh e musikorësh  
 e fyellorësh e trumpetarësh nukë dotë dë-  
 gjonetë më te ti; edhe çdo mjeshtëri prej çdo  
 farë mjeshtërie nukë dotë gjëndetë më te ti;  
 edhe zë mulliri nukë dotë dëgjonetë më te ti;  
 23 Edhe dritë kandileje nukë dotë ndritnjë më  
 te ti; edhe zë dhëndërri e nuseje nukë dotë

dëgjonetë më te ti; sepse tregëtarët' e tu i-  
 shinë të-mëdhenjt' e dheut, sepse me magjinë  
 24 t'ënde ukobuanë gjithë kombetë. Edhe nd' atë  
 ugjënt gjak profitërsh e shënjtorësh edhe të  
 gjith' atyreve që janë therurë mbi dhet.

#### Krye 19.

- 1 Edhe pastaj dëgjova posi një zë të-math  
 shumë gjindjeje ndë qiellt që thoshte, Alilluja,  
 shpëtimi e lavdia e nderi e fuqia *qoftë* mbë  
 2 (Zotinë) Perëndinë t'ënë; Sepse gjykoj kurvën'  
 e-madhe që prishi dhenë me kurvërin' e saj,  
 edhe mori çpagim prej dorës' s'asaj për gja-  
 3 kun' e shërbëtorëvet të ti. Edhe për-së-dyti  
 thanë, Alilluja. Edhe tymi i asaj hipën ndë  
 4 jetët të jetëvet. Edhe ranë të njëzet e katrë  
 pleqtë, edhe të katrë shtëzëtë, e i ufaInë Pe-  
 rëndisë që rrinte mbi front, dyke thënë, A-  
 5 min; Alilluja. Edhe doli nga froni një zë që  
 thoshte, Lavduron Perëndinë t'ënë, gjithë ju  
 shërbëtorët' e ati, ju që i keni frikë ati, edhe  
 të-vegjëlit' e të-mëdhenjtë.  
 6 Edhe dëgjova posi një zë shumë gjindjeje,  
 edhe posi një zë shumë ujërash, edhe posi  
 një zë bumbullimash të-forta, që thoshinë, Ali-  
 lluja; se mbretëroj Zoti, Perëndia Gjithëpu-  
 7 shtetës. Letë gëzonemi, e letë gasmonemi, e let'  
 i apëmë ati lavdinë, sepse erdhi dasma e Qën-  
 gjit, edhe gruaja e ati bëri gati vetëhen' e saj.  
 8 Edhe i udha asaj të vishetë me vishnje të-

pastrëtë e të-ndriturë; sepse vishnjeja është të-drejtat' e shënjtorevet.

- 9 Edhe më thotë, Shkruaj, Lum ata që janë ftuarë ndë dasmët të Qëngjit. Edhe më thotë, Këto janë fjalët' e-vërteta të Perëndisë.
- 10 Edhe rashë përpara këmbëvet t' ati që t' i falem; edhe ay më thotë, Vështro, semos bënçq *këtë*; sepse unë jam bashkëpunëtori yt edhe i vëllezërvet të tu që kanë dëshmimi' e Jisujt; *po fal-i-u* Perëndisë; sepse dëshmimi i Jisujt është fryma e profitisë.
- 11 Edhe pashë qiellinë të-hapurë, edhe ja një kal' i-bardhë, edhe ay që rrinte mb' atë quhej Besëtar edhe i-Vërtetë, edhe me drejtëri
- 12 gjykon e lufton. Edhe syt' e ati *ishinë* posi flakë zjarri, edhe mbi kryet t' ati *kishte* shumë kurorë; edhe kishte një emër të-shkruarë,
- 13 të-cilinë asndonjë s'e di veç ay. Edhe ishte veshurë me një rrobë ngjyerë ndë gjak; edhe
- 14 emër' i ati quhetë *Fjala e Perëndisë*. Edhe ushtëritë që ishinë ndë qiellit i vininë prapa hipurë mbi kuaj të-bardhë, e veshurë me
- 15 vishnje të-bardhë edhe të-pastrëtë. Edhe prej gojës' s' ati dilte një shpat' e-prehëtë, që t'u bjerë kombevet me atë; edhe ay „dot' i kullošnjë ata me shkop të-hëkurtë;“ edhe ay shkel tirën' e verës' së zëmërimt edhe të zëmëratës' së Perëndisë Gjithëpushtetës. Edhe mbi rrobët e mbi kofshët të ti ka të-shkruarë emërinë, *Mbret i mbretërvet edhe Zot i zotërvet*.

- 17 Edhe pashë një ëngjëll që rrinte ndë djellët; edhe thërriti me zë të-math, dyke thënë gjithë shpesvet që fluturonjënë ndë mest të qiellit, Ejani edhe mblidhuni ndë darkët të
- 18 Perëndisë të-math, Që të hani mishra mbretërshe, e mishra kryemijësve, e mishra të-for-tësh, e mishra kuajsh edhe t' atyreve që kanë ndënjurë mbi ata, edhe mishra të të-gjithëve, të-lirëve e shërbëtorëve, edhe të-ve-gjëlve e të-mëdhenjve.
- 19 Edhe pashë bishënë edhe mbretërit' e dheut, edhe ushtërit' e atyreve mbledhurë, që të bëninë luftë me atë që rrinte mbi kallët, edhe
- 20 me ushtërin' e ati. Edhe uzu bisha, edhe bashkë me atë profiti gënjeshtar, ay që bëri shënjatë përpara asaj, me të-cilatë koboja ata që muarnë të-gërvishturit' e bishësë, edhe ata që i ufalné ikonës' s' asaj; të-gjallë uhothné që të dy ndë lëqert të zjarrit që digjetë me
- 21 squfur. Edhe të-tjerët' uvrinë me shpatën' e ati që rrinte mbi kallët, e-cila dilte prej gojës' s' ati; edhe gjithë shpest' unginjë nga mishrat' e atyreve.

#### Krye 20.

- 1 Edhe pashë një ëngjëll dyke sbriturë nga qielli, i-cili kishte hapësin' e pafundjesë, edhe
- 2 një vark të-math ndë dorët të tij. Edhe zuri draguanë, gjarpërin' e-moçim, i-cili është Djalli edhe Satanaj; edhe e lidhi atë një mijë vjet.

- 3 Edhe e hodhi ndë pafundjet, edhe e mbylli, edhe vuri vulë sipër' ati, që të mos kobonjë më kombetë, gjersa të mbaronenë të një mijë vjettë; edhe paskëtaj duhetë të sgidhetë për pak kohë.
- 4 Edhe pashë frone; edhe ndënjne mbi ata, edhe gjyq udha ndër ata; edhe pashë shpirtërat' e atyreve që ishinë therurë për dëshmimin' e Jisujt, edhe për fjalën' e Perëndisë, edhe të-cilëtë nuk' i ufalné bishësë, as ikonës' s'asaj; edhe nukë muarnë të gërvishturitë mbi ballët të tyre edhe mbi dorët të tyre; edhe rruan' e mbretëruanë bashkë me Kri-
- 5 shtinë ata të një mijë vjettë. Edhe të vdekurit' e-tjerë nuk' ungjallné, gjersa të mbushenë të një mijë vjettë; këta është të-ngjallurit' e-parë.
- 6 I-lumur' edhe shënjt është ay që ka pjesë ndë të-ngjallurit të-parë; mbi këta vdekj' e-dytë s'ka pushtet, po dotë jenë priftër të Perëndisë, edhe dotë mbretëronjënë bashkë me atë një mijë vjet.
- 7 Edhe kur të mbaronenë të një mijë vjettë,
- 8 dotë sgidhetë Satanaj nga burgu i ti. Edhe dotë dalë të kobonjë kombetë që gjëndenë mbë të katrë anët' e dheut, Gogun' e Magogunë, që t'i mbledhë ata për luftë, numër' i
- 9 të-cilëvet është posi rër' e detit. Edhe hipné mbë të-gjerët' e dheut, edhe qerthëlluanë ushtërin' e shënjtorëvet, edhe qytetin' e-dashurë; edhe shbriti zjarr prej qiellit nga Perëndia,

- 10 edhe i hëngri. Edhe djalli që kobonte ata, uhoth ndë lëqert të zjarrit e të squfurit; ku ishte bisha edhe profiti gënjeshtar; edhe dotë mundonenë dit' e natë, ndë jetët të jetëvet.
- 11 Edhe pashë një fron të-bardhë e të-math, edhe atë që rrinte mb' atë, prej faqes' së të-cilit iku dheu edhe qielli; edhe nuk' ugjënt
- 12 vënt për ata. Edhe pashë të-vdekuritë, të-vegjël' e të-mëdhejn, rrininë përpara Perëndisë, edhe vivliat' uhapné; edhe uhap një vivli tjetërë, e-cila është e jetësë; edhe ugjy-
- 13 kuanë të-vdekuritë nga ato që ishinë shkruarë ndë vivliat, pas punëravet të tyre. Edhe deti dha të-vdekuritë që ishinë nd' atë, edhe mortja edhe hadhi dhanë të-vdekuritë që ishinë ndër ata; edhe ugjykuanë gjithësicili
- 14 pas punëravet të tyre. Edhe mortja edhe hadhi uhothné ndë lëqert të zjarrit; këjo është
- 15 vdekj' e-dytë. Edhe ay që s'ugjënt shkruarë ndë vivlit të jetësë, uhoth ndë lëqert të zjarrit.

#### Krye 21.

- 1 Edhe pashë një qiell të-ri edhe një dhe të-ri; sepse qielli i-parë edhe dheu i-parë
- 2 shkoj; edhe deti nuk' është më. Edhe (unë Joani) pashë qytetin' e-shënjtëruarë, Jerusolimën' e-re, dyke sbriturë prej qiellit nga Perëndia, q' ishte bërë gati posi nuse e-stolisurë për
- 3 burrin' e saj. Edhe dëgjova një zë të-math nga qielli që thoshte, Ja tenda e Perëndisë

- bashkë me njerëzitë, edhe dotë rrijë bashkë me ata, edhe ata dotë jenë llauzi i ati, edhe Perëndia vetë dotë jetë bashkë me ata Perëndia rëndi i atyreve. Edhe (Perëndia) dotë fshijë çdo lot nga syt' e atyreve, edhe vdekja nukë dotë jetë më; as vajë, as të-bërtiturë, as të-dhëmburë nukë dotë ketë më; sepse të-paratë shkuanë.
- 5 Edhe tha ay që kishte ndënjurë mbi front, Ja të-gjitha tek i bënj të-ra. Edhe më thotë, Shkruaj; sepse këto fjalë janë të-vërteta edhe 6 të-besuara. Edhe më tha, Umbarua; unë jam Alfa edhe Omega, të-nisurit' edhe të-mbaruarëtë. Unë dot' i ap dhurëti ati që ka et nga 7 burimi i ujit të jetësë. Ay që munt dotë trashëgonjë të-gjitha, edhe dot' i jem Perëndi, 8 edhe ay dotë më jetë bir. Edhe frikacarët' e të-pabesët' e të-ndyrët' e vrasësit' e kurvarët' e magjistarët' e idhullatrët' e gjithë gënjeshtarëtë dotë kenë pjesën' e tyre ndë lëqert që digjetë me zjarr e me squfur; këjo është vdekj' e-dytë.
- 9 Edhe erdhi tek unë një nga të shtatë ëngjëjtë që kishinë të shtatë botilatë mbushurë me të shtatë plagët' e-pastajme, edhe foli bashkë me mua, dyke thënë, Eja, dotë të 10 dëftenj tyj nusenë, gruan' e Qëngjit. Edhe më shpuri me frymë ndë një mal të-math e të-lartë, edhe më dëfteu qytetin' (e-math), Jerusalimën' e-shënjtëruarë, dyke sbriturë prej qi-

- 11 ellit nga Perëndia, Që kishte lavdin' e Perëndisë; edhe të-ndriturit' e asaj shëmbëllente me gur fort të-çëmuarë, posi me gur jaspi-
- 12 dhe që shkëlqente si krystall. Edhe kishte një mur të-math e të-lartë; kishte edhe dy-mbëdhjetë porta, edhe mbi portat dy-mbëdhjetë ëngjëj, edhe emëra të-shkruarë përsipër, të-ciletë janë emërat' e të dy-mbë-dhjetë faravet
- 13 të bijvet të Israilit. Nga ana që lint djelli, tri porta, nga an' e borësë, tri porta; nga an' e mesditësë, tri porta; nga an' e perëndimit, tri 14 porta. Edhe muri i qytetit kishte dy-mbë-djetë themele, edhe nd' ata *ishin'* emërat' e të dy-mbë-dhjetë apostojvet 'ë Qëngjit.
- 15 Edhe ay që fliste bashkë me mua kishte një kallam t'artë, që te matte qytetin' edhe 16 portat' e ati edhe murin' e ati. Edhe qyteti ishte me katër çipa, edhe ishte sa i-gjatë, kaqë edhe i-gjerë; edhe mati qytetinë me kallamnë, gjer mbë dy-mbë-dhjetë mijë stadhe; të-gjatët' e të-gjerët' e të-lartët' e ati janë si-një-një.
- 17 Edhe mati murin' e ati, një qint e dyzet e katër kut, pas masës' së njeriut, do-me-thënë, 18 të ëngjëllit. Edhe ndërtesa e murit t'ati ishte jaspidhë; edhe qyteti ar i-kulluarë që shëm-
- 19 bëllente me qelq të-kulluarë, Edhe themelet' e murit të qytetit *ishinë* stolisurë me çdo farë gurësh të-çmuarë; themel' i-parë ishte aspindhë; i-dyti, sapfir; i-treti, halqidhon; i-ka- 20 tërti, smaragdh; i-pesëti, sardhonik; i-gjashtëti,

- sardhi; i-shtatti, gur ari; i-tetti, viryl; i-nëntti, topaz; i-dhjetti, krysopras; i-një-mbë-dhjetti, 21 jaqinth; i-dy-mbë-dhjetti, amethyst. Edhe të dy-mbë-dhjetë portat' ishinë dy-mbë-djetë margaritarë, gjithësicila portë ishte prej një margaritari; edhe udh' e qytetit *ishte* ar' i-kulluarë, posi qelq i-ndëpërdukshim.
- 22 Edhe tempull nukë pashë nd' atë; sepse tempull' i ati është Zoti, Perëndia. Gjithëpushtetës, edhe Qengji. Edhe qyteti s'ka nevojë prej djelli, as prej hëne, që të ndritnjënë nd' atë; sepse lavdia e Perëndisë e ndriti atë, edhe 24 kandilej' e asaj është Qëngji. Edhe kombet' (e të shpëtuarëvet) dot' ecënjënë ndë dritët t'ati; edhe mbretërit' e dheut bjenë lavdin' e 25 nderin'e tyre mb' atë. Edhe portat'e ati nukë dotë mbyllënë ditënë; sepse natë nukë dotë 26 ketë atje. Edhe dotë bjenë lavdin' edhe nderin' e kombevet mb' atë. Edhe nukë dotë hy-një nd' atë asndonjë *gjë* që pëgër e bje ndyrësi, e gënjeshtëtrë; po vetëm' ata që janë shkruarë ndë vivlit të jetës' së Qëngjit.

#### Krye 22.

- 1 Edhe më dëfteu një lumë (të kulluarë) me ujë të jetësë, të-shkëlqyerë posi krystall, që dilte prej fronit të Perëndisë edhe të Qëngjit.
- 2 Ndë mest të udhës' së *qytetit*, edhe mbë kët' anë e mb' at' anë të lumit, ishte drur' i jetësë që ep dy-mbë-dhjetë pemë, dyke bërë mbë çdo muaj pemën' e ti; edhe fletët' e drurit

- 3 *janë* për shërim të kombevet. Edhe asndonjë mallëkim nukë dotë ketë më: edhe fronti i Perëndisë edhe i Qëngjit dotë jetë nd' atë; edhe shërbëtorët' e ati dot'a adhuronjënë atë.
- 4 Edhe dotë shohënë faqen' e ati, edhe emëri 5 i ati dotë jetë mbi ballërat t'atyre. Edhe natë nukë dotë ketë atje; edhe s'kanë nevojë prej kandileje e prej drite djelli, sepse Zoti, Perëndia, i ndriti ata; edhe dotë mbretëronjënë ndë jetët të jetëvet.
- 6 Edhe më tha, Këto fjalë *janë* të-besuara edhe të-vërteta; Edhe Zoti, Perëndia i profitërvet të-shënjtëruarë, dërgoj ëngjëllin' e tij, që t'u dëftentë shërbëtorëvet të ti sa duhetë të bënenë për-së-çpejti. — Ja tek vinj çpejt; 7 lum ay që ruan fjalët' e profitis' së kësaj vivlie.
- 8 Edhe unë Joani jam ay që pashë e dëgjova këto; edhe kur dëgjova edhe pashë, rashë të falem përpara këmbëvet t'ëngjëllit 9 që më dëftente këto. Edhe ay më thotë, Vësh-tro semos *bënjç këtë*; sepse jam bashkëshërbëtori yt, edhe i vëllezërvet të tu profitër, edhe i atyreve që ruanjënë fjalët' e kësaj vivlie; *po* fal-i-u Perëndisë.
- 10 Edhe më thotë, Mos vulosç fjalët' e profitis' së kësaj vivlie; sepse koha është afërë.
- 11 Ay që bën paudhëri, letë bënjë paudhëri edhe më; edhe ay që është i-shgërryerë, letë shgërryner' edhe më; edhe i-drejti letë bënet' i-drejtit edhe më; edhe i-shënjtëruari letë 12 shënjtëronet' edhe më. Edhe ja tek vinj çpejt;

- edhe paga ime *është* bashkë me mua, që t'ja paguanj gjithësicilit sikundër dotë jetë pun' e  
13 ati. Unë jam Alfa e Omega, të-nisurit' edhe të-mbaruarëtë i-pari edhe i-pastajmi.
- 14 Lum ata që bënëjënë porosit' e ati, që të kenë pushtet mbë drurin' e jetësë, edhe me  
15 anë të portavet të hynjënë ndë qytett. Edhe jashtë janë qënt' e magjistarët' e kurvarët' e vrasësit' e idhullatrëtë, edhe kushdo qe do e  
16 bën gënjeshtrenë. Unë Jisuj e dërgova ëngjëllinë t'im që të dëshmonjë ndër ju për këto ndëpër kishët; unë jam rrënja edhe fara e Dhavidhit, ylli i-ndriçim edhe i mëngjesit.
- 17 Edhe Fryma edhe nuseja thonë, Eja; edhe ay qe dëgjon, letë thotë, Eja; edhe ay që ka et, letë vinjë; edhe ay që do, letë marrë dhurëti ujët' e jetësë.
- 18 (Sepse) ap dëshmim mbë gjithësicilinë që dëgjon fjalët' e profitis' së kësaj vivlie. Nde shtoftë ndonjë mbë këto, Perëndia dot' i shtonjë ati plagëtë *që janë* shkruarë ndë këtë  
19 vivli. Edhe ndë heqtë ndonjë *njeri* nga fjalët e vivlis' së kësaj profitie, Perëndia dotë heq-një pjesën' e ati nga vivlia e jetësë, edhe nga qyteti i-shënjtëruarë, edhe nga ato që janë shkruarë ndë këtë vivli.
- 20 Ay që dëshmon për këto thotë, Po vinj çpejt, Amin, po eja, o Zoti Jisu.
- 21 Hiri i Zotit t'ënë Jisu Krisht *qoftë* bashkë me ju të-gjithë. Amin.

FUNT.